



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE
DREJTORI PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

Nr. 2051/12 prot

Pukë, më 30.01.2024

PROJEKT-VENDIM
NR. 03 , Date 30 , 01 , 2024

PER RISHQYRTIMIN E VENDIMIT NR.52 DATE 29.12.2023 MIRATIMIN E DHENIEN NE PERDORIM NGA FONDI PYJOR TE NJE SIPERFAQE PYJORE PUBLIKE PREJ:2.5 HA NE EKONOMITE PYJORE; "TERBUN, KUZHNEN, LIVADH HAMZI"GOJAN SHKOZE"

PËR AKTIVITET:

VENDOSJE ANEMOMETRI PER STUDIMIN DHE MATJES SE SHPEJTESISE SE ERES NGA SHOQERIA "GO GREEN" SH.P.K

Ne zbatim te Ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore" ; Ligit Nr.57/2020 "Per Pyjet" ; Ligjit Nr. 107/2014 "Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar VKM-në Nr.408 date 13.05.2015 "Per miratimin e Rregullores st Zhvillimit te Territorit i ndryshuar; "VKM-në nr. 134 date 3.3.2021 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.433 date 08.06.2016 te keshillit te ministrave "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim i Ministrise se Mjedisit e te ish Komunave/Bashkive" te ndryshuar , Udhezimi nr.1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik" ; Shkreses nr.7754 Prot date 28.10.2021 "Kerkese per bashkepunim mbi ankandin për energjine e eres" nga Ministri i Infrastruktures dhe Energjise ; Memo Informacion mbi ankandin për energjine e eres per perzgjedhjen e projekteve te eres ne toke me vendndodhje te percaktuar nga zhvilluesit që do te perfitojne masa mbeshtetese" nga Ministri i Infrastruktures dhe Energjise si dhe referuar kerkese NR prot 2051/3 "Kerkese per dhenie ne perdorim me qira te siperfaqeve te ndodhura ne juridiksionin territorial te bashkise Puke për vendosjen e Anemometri te Matjes se Shpejtesise se Eres" nga Subjekti "GO GREEN " Sh.p.k;

"Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave te dhenie ne perdorim nga fondi pyjor nga ana e Këshillit Bashiak brenda territorit Administrativ te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave te dhenie ne perdorimi /heqje nga fondi pyjor" pasi shqyrtimit te dosjes me dokumentacionin perkatës konform edhe ndaj Udhezimi nr.1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik"PIKA 22 Germa J, eshte ngritur grupi i punes me Urdherit te Kryetarit nr . nr 692 date 22.12.2023 "Per pregatitjen e raportit tekniko-ekonomik për vendosjen e Anemometri te Matjes se Shpejtësise se Eres" për Subjektin "GO GREEN" Sh.p.k dhe fillimin e procedurave per dhenie ne perdorim te siperfaqes fond pyjor.

Dosja e sjelle nga "GO DREEN për vendosjen e Anemometri te Matjes se Shpejtësisë se Eres" ka keto dokumenta

Nr.	Titulli i Dokumentit	Dokument i plotësuar sipas Udhezimit nr.1 date 09.06.2016	Shenime
1	Shkreses nr.7754 Prot date 28.10.2021 "Kerkese per bashkepunim mbi ankandin per energjine e eres"nga Ministri i Infarstruktures dhe Energjise	PO	
2	"Memo Informacion mbi ankandin per energjine e eres per perzgjedhjen e projekteve te eres ne toke me vendndodhje te percaktuar nga zhvilluesit qe do te perfitojne masa mbeshtetese"nga Ministri i Infrastruktures dhe Energjise	PO	
3	Kerkesa NR 2051/3 Date 14.11.2023 "Kerkese per dhenie ne perdorim me qira te siperfaqeve te ndodhura ne juridiksionin territorial te bashkise Puke për vendosjen e Anemometri te Matjes se Shpejtësisë se Eres"nga Subjekti "GO GREEN"Sh.p.k	PO	
4	Pershkrim Projektin Teknik	PO	
5	Ortofoto me pikat e kerkuara	PO	
6	Leje	PO	

Me propozim te Kryetarit,Keshilli I Bashkise

VENDOSI

1. Dhënien ne perdorim te siperfaqje si me poshte

1. Parcela **78/a** ekonomia pyjore Terbuin do te vendosen 1 shtylla Anemometri dhe siperfaqja qe do te me qera nga fondi pyjor eshte **2500 m²**
2. Parcela **84/a** ekonomia pyjore Terbuin do te vendosen 1 shtylla Anemometri dhe siperfaqja qe do te me qera nga fondi pyjor eshte **2500 m²**
3. Parcela **77** ekonomia pyjore Kuzhnen do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor eshte **2500m²**
4. Parcela **69/a** ekonomia pyjore Kuzhnen do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do tehiqet nga fondi pyjor eshte **2500m²**
5. Parcela **25/c** ekonomia pyjore Livadh-Hamez do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor eshte **2500m²**
6. Parcela **35a** ekonomia pyjore Livadh-Hamez do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor eshte **2500m²**
7. Parcela **50d** ekonomia pyjore Livadh-Hamez do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do te jepet me qera nga fondi pyjor eshte **2500m²** .
8. Parcela **7** ekonomia pyjore Gojan-Shkoze do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe siperfaqja qe do te jepet me qera nga fondi pyjor eshte **2500m²**

9. Parcela **8a** ekonomia pyjore Gojan-Shkoze do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe sipërfaqja qe do te jepet me qera nga fondi pyjor eshte **2500m²**
10. Parcela **84** ekonomia pyjore Gojan-Shkoze do te vendosen 1 shtylla e Anemometri dhe sipërfaqja qe do te jepet me qera nga fondi pyjor eshte **2500m²**

2. Per dhenien e dakordesise per dhenien ne përdorim te sipërfaqes prej 2.5 Ha (ha Vendosje Anemometri te Matjes Shpejtsise se Eres dhe vazhdimin e procedura ligjore per lidhjes e kontrates se qerese nga Bashkia Puke dhe velja e te ardhurave
3. Sipërfaqet qe jepen ne perdorim nga fondi pyjor me ngastra dhe nenngastra jane te ndara si me posht: **Aneksi nr.1 bashkelidhur këtij P/Vendimi**
4. Afati i dhenjes me perdorimi per vendosjen e Anemometri eshte 2 vjeçar
5. Tarifat jane percaktuar ne piken 8 te lidhjes nr 1 te V.K.M Nr 559, datë 29.07.2022 "Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore
6. Per vazhdimin e procedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr 1/2016 te Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet Struktura Pergjegjese Per pyjet dhe Kullotat ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore,
7. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Struktura Pergjegjese Per pyjet dhe Kullotat, zyra kadastres pyjore
8. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6.e ligjit nr 139/2015"Per veteqeverisjen vendore"

HARTUESI

Ing Edmond Prendi



JURISTI

Aida Sinani



KRYETARI

RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

Nr. 2051/13 prot

Pukë, më 30.01.2024

RELACION

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR PER
VEDOSJES PER E ANOMETRIT PER STUDIMIN E ERES NGA SUBJEKTI "GO GREEN" SHPK

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullosore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullosor eshte ligji nr 57/2020 si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te neneve 15 dhe 17 te ketij ligji, Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik",

Bazuar ne aktet e mesiperme dhe ne kerkesen e bere nga ana Subjektit "GO GREEN" Sh.p.k,e protokolluar me Nr 2051/3 date 14.11.2023 per vendosjen e 10 Shtyllave per studimin e eres dhe marrjen ne perdorim te siperfaqes pyjore dhe konkretisht ne

Parcelat 78a,84a ekonomia pyjore Terbutun,

Parcela 69,77 ekonomia pyjore Kuzhnen,

Parcelat 25c,35a,50d ekonomia pyjore Livadh-Hamzi

Parcelat 7,8a,84 ekonomia pyjore Gojan-Shkoze.

Bashkise Puke sipas V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim i Ministrise se Mjedisit e te ish Komunave/Bashkive" te ndryshuar ne baze Urdherin te kryetarit te Bashkise nr .692 date 22.12.2023 per pergatitje e raportit tekniko-ekonomik te vleresimit financiar per vendosjen e 10 anometrave per studimin e eres nga Subjektit "GO GREEN" eshte ngritur grupi I punes perbere nga ing Astrit Hyseni , ing Shkelzen ing.Edmond

Prendi, per hartimin e raportit tekniko-ekonomik te vleresimit financiar ku dhe jane percaktuar siperfaqet pyjore qe do te jepen ne perdorim dhe siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor kullosor dhe volume I materialit drusore qe do te demtohet nga punimet per vendosjen e turbine eolike.

kerkohet miratimi nga keshilli Bashkiak per dhenjen ne perdorim nga fondi pyjor te siperfaqjeve te kerkuara dhe vazhdimin e procedure per lidhjen e kontrates se qerases me bashkine.

Ne menyre te permblledhur siperfaqe pyjore do jepen ne perdorimi me kontrate qeraje jane ne keto ekonomi pyjore ne territorin e Bashkise Puke

- Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore Terbutun," parcelat 78a,84a siperfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²
- Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Kuzhnen" parcelat 69,77 a siperfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²
- Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Livadh-Hamzi" parcelat 25c,35a,50d siperfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m²
- Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Gojan-Shkoze" parcelat 7,8a,84 siperfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m²
- Siperfaqja totale qe kerkohet te jepet ne perdorimi eshte 2.5 ha
- Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e project vendimit per vijimin procedurave nga ana Ministrise Turizmit dhe Mjedisit ku kerkohet miratimi me shkrim nga ana keshillit Bashkiak per vijimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor kullosor

Hartuesi i relacionit

Edmond Prendi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Drejtoria Përgjegjëse për pyjet dhe kullotat

Nr. 205/14 prot:

Puke, me 30.04. 2024

URDHËR
Nr. 48, Datë 30.04.2024

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TEKNIKO EKONOMIK
DHE VLIJIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNJE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR
PUBLIK TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 2.5 HA QË NUK NDRYSHONË KATEGORINË E
PËRDORIMIT NË FUNKSION PËR VENDOSJEN E EREMATESVE PËR STUDIMIN E ERES
DHE NGA SHOQERIA "GO DREEN" SH.P.K**

Në mbështetje të ligjit 139 viti 2015 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor 57/20 "Për pyjet të ndryshuar, Udhezimin nr 1 date 09.06.2016 Për rregullat, procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjore dhe kulloror pika 10 e ketij udhezimi Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si mësipër kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke

URDHËROJ:

1. Vlijimin e procedurave që duhet të ndjekë Drejtoria përgjegjëse për pyjet në bashkinë Puke për dhenjen ne perdorim të një sipërfaqeje prej 2.5 ha

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore Terban," parcelat 78a,84a sipërfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Kuzhnen" parcelat 69,77 a sipërfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Livadh-Hamzi" parcelat 25c,35a,50d sipërfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Gojan-Shkoze" parcelat 7,8a,84 sipërfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m²

2. Shoqëria "Go DREEN" SHPK, duhet të rehabilitojë sipërfaqet objekt studimi sipas planit të rehabilitimit dhe lejes mjedisore si dhe të pyllëzojë me drurë pyjorë, brenda vitit të parë, një sipërfaqe prej 2.5 ha sipas marrëveshjes me Bashkinë Puke .

- a. shënojë në terren poligonin me sipërfaqen pyjore objekt i përdorimit për vendosje anonimetrit bëjë vlerësimet në volum e vlerë për lëndën drusore dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe mbajë aktet përkatëse,
- b. monitorojë në vite detyrimet përkatëse dhe kryerjen e procedurave në terren për reabilitimin, pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve në përdorim.
4. Shoqëria të kryejë pagesat e menjëhershme në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Puke, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe tarifen e përdorimit për vitin e parë e në vijim.
5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore publike të identifikuar sipas lidhjes 1 (një) të këtij vendimi, nga kategoria "Tokë e zënë pyjore" dhe e regjistron në kategorinë "Tokë e zënë, objekt anonimetrit për . Te behen ndryshimet në regjistrin kadastral për sipërfaqet pyjore
6. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Drejtoria Përgjegjëse Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Puke,

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Ju faliminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

RRËK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

Nr. 2051/prot
15

Pukë, më 30.01.2024

RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO - EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM / NGA FONDI
PYJOR PER STUDIMIN DHE VEDOSJES SE ANEMOMETRIT TE MATJES SHPEJTESIS SE ERES
NGA SUBJEKTI "GO GREEN" SHPK**

Bazuar në kërkesen e shoqërisë "GO GREEN" Sh.p.k nr prot 2051/3 date 14.11.2023 per studimin dhe vendosjen e anemometrit te matjes se shpejtesis se eres Ne baze te Urdhërin të kryetarit të Bashkisë nr 692 date 22.12.2023 për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore qe do te jepen ne perdorimi , grupi I punës I përbërë nga ing Astrit Hyseni , ing Edmond Prendi studioi kërkesën e subjektit " GO GREEN" Sh.p.k dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore object per studimin dhe vendosjen e aerogjeneratoreve dhe studimin per anemometrit te matjes se shpejtesis se eres Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastral/nëngastra

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore Terbut," parcelat 78a,84a siperfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Kuzhnen" parcelat 69,77 a siperfaqja qe jepet ne perdorimi 5000m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Livadh-Hamzi" parcelat 25c,35a,50d siperfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m²

Ekonomia Pyjore "ekonomia pyjore "Gojan-Shkoze" parcelat 7,8a,84 siperfaqja qe jepet ne perdorimi 7500 m² dhe janë në pronësi/administrim te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 përshkrimi parcelar I sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat të këtij raporti.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik e Vendimit te keshillit Bashkiak dhe akteve të tjera normative si mësipër, Subjekti "GO GREEN" Sh.p.k kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke dhe likujdimit të tarifës prej **671000 leke**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në piken Nr.8 te shtojce Nr1 te VKM-ve Nr. 559 datë 29.07.2022 "Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore keto bazohen në afatin kohor sipas grafikut të

punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsistonnë:

Sipërfaqja totale qe kerkohet te jepet ne perdorimi eshte 2.5 ha

1 . Vlera e përdorimit për sipërfaqen e dhene jepen perdorim

Toke me bimesi pyjore trunqishte 2.5 ha x 230.000 lek = 575000lekë

TOTALI 575000 Lekë

Vlera e bimesise pyjore,flores dhe faunes perbehet nga:

Vlera lendes punimit 20 m³ x 3000 leke = 60000 Lekë

Vlera e drureve te zjarrit te Dushqe 60m³ x 600 leke = 36000 lekë

TOTALI 96000 Lekë

PERPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO -EKONOMIK

ING Edmond Prendi



Ing Astrit HYSENI



MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
RROK DODAJ

